

## **Human Rights Youth Club of Gjilan/Gnjilane Region**

### *Name of organisation:*

**OSCE Regional Centre Gjilan/Gnjilane**

Bregu i djegur P.N.

Gjilan/Gnjilane

Kosovo/UNMIK

Contact person: Claire Fernandez

**Përshkrim i shkurtër:** Klubi Rinor për të Drejtat e Njeriut është një grup multi-etnik i përbërë prej 30 nxënësve të cilët punojnë së bashku për të zhvilluar aktivitete lidhur me të drejtat njerëzore. Pjesëmarrësit, që i përkasin komunitetit të shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe romëve nga lokalitete të ndryshme të regjionit të Gjilanit, janë të involvuar në qasjen “mësojmë duke vepruar/bërë”, që i jep mundësi dhe inkurajon të rinjtë të marrin pjesë në mënyrë aktive. Me përkrahjen e OSBE-së, Misionit në Kosovë, ky grup ka punuar në projektin e tij të parë: Një ekspozitë shetitëse mbi situatën e të drejtave të njeriut nga e tërë bota.

**Audienca e caktuar:** Nxënësit e shkollave të mesme

**Hapsira momentale gjeografike:** Kosovo/UNMIK (Regjioni Gjilan)

**Gjuhët në dispozicion:** Gjuhë angleze, shqipe dhe serbe

**Hapsirat tematike:** Toleranca, edukimi jo-diskriminues

**Tipi i qasjes:** Mësimdhënia dhe praktikat e nxënies dhe mjetet

**Informata në lidhje me kontekstin në të cilin materiali është prodhuar:** Grupi së pari u takua me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (10 Dhjetor 2008), në një trajnim një ditor për jo-diskriminim dhe barazi. Trajnimi ishte ndjekur nga 24 nxënës të shkollës së mesme dhe 4 mësues nga tre komuna të regjionit. Qeveria komunale përkrahu iniciativën duke siguruar transport për në vendin e ngjarjes dhe prej anasjelltas për studentët. Projekti ishte një sukses i madh duke iu falenderuar bashkëpunimit të OSBE-së, drejtorëve të shkollave, dhe qeverisjes komunale. Pjesëmarrësit e rinj ishin entusiast për të mësuar më shumë për konceptet e të drejtave të njeriut. Duke i dhënë rëndësi, nxënësit dhe arsimtarët shprehën një interesim të madh që përveç ngjarjeve një ditore të krijojnë një forum të rregullt, në të cilin nxënësit mund të forcojnë dituritë e tyre në temat lidhur me të drejtat njerëzore.

Drejtë perfundimit, OSBE-ja dhe pjesëmarrësit e rinj filluan të kërkojnë mundësi për të krijuar një Klub Rinor për të Drejtat e Njeriut. Gjatë mbledhjes paraprake të organizuar në lokalet e OSBE-së, përafërsisht 45 nxënës dhe mësues nga regjioni ishin mbledhur për të vendosur themelin e Klubit për të Drejtat e Njeriut të Regjionit të Gjilanit. Nxënësit u fokusuan në përbërjen e Klubit, rregullat e proceduarve dhe idetë për aktivitete. Aktiviteti i parë ishte një ekspozitë e fotografive, mbi situatat e të drejtave të njeriut rreth botës, të cilat do të shërbenin si një aktivitet për ngritjen e informimit efektiv. Grupet punuese ishin formuar, dhe sesionet përcjellëse ishin mbajtur në përgatitje të ekspozitës, të cilat u mbajtën gjatë gjithë regjionit të Gjilanit. Në mënyrë specifike, pjesëmarrësit e rinj, zgjedhën fotografi për ekspozitë, zgjedhën titullin e ekspozitës,

dizajnuan një poster për të lajmëruar ngjarjen, përgatitën ftesat, dhe ishin të kyqyr në procesin e përkthimit dhe shtypjes, si dhe në organizimin e ekspozitës në të gjitha lokalitetet.

**Burimet njerëzore dhe financiare që kërkohen për të implementuar përvojën dhe qëndrueshmërinë e saj:** Përvoja kërkohet më shumë në qështje të burimeve njerëzore , se sa në ato financiare,. Përafërsisht 10 anëtarë të personelit të OSBE-së janë duke punuar për të përkrahur Klubin për të Drejtat e Njeriut. Përveç koordinimit (pjesëmarrësit vijnë nga lokalitete të ndryshme , shpesh të largëta) shpjegimi dhe përkthimi janë një prej detyrave që marrin shumë kohë. Komunikimi ndërmjet të rinjëve shqipfolës dhe atyre serbfolës është pothuajse e pamundur pa përkthyes, përderisa vetëm disa mund të flasin anglisht. Bugjeti për të implementuar përvojat është i vogël , duke përfshirë transportin dhe materialet për aktivitetet.

Përvoja është vetëm në fazat fillestare , kështu që është ende e vështirë për të vlerësuar qëndrueshmërinë. Hapat e tjerë do të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve të Klubit (trainimet gjuhësore, trainimet për të drejtat e njeriut dhe trainimet për menagjimin e projekteve), që në mënyrë progresive të tërheqin pjesëmarrjen e OSBE-së.

**Sa është përvoja unike në adresimin e temave thelbësore të përmbledhjes:** Përvoja është unike në atë kuptim se ajo ve vlerat e të drejtave njerëzore në praktikë, nga një fakt i thjeshtë se të rinjtë nga komunitetet e ndryshme janë duke punuar së bashku.Sa i përket rastit të Kosovës, ku shumë shpesh lidhjet sociale janë shkëputur ndërmjet komuniteteve të ndryshme , duke punuar në një projekt të përbashkët është një mënyrë për të rinjtë, për të krijuar këto lidhje që mungojnë. Vëmendja nuk është e vendosur në rezultat por në proces. Janë bërë shumë përpjekje nga ekipet e terrenit të OSBE-së për të mbajtur grupet më të prekshme dhe komunitetet jo shumicë të izoluara të përfshira në këtë, pamvarsisht kontekstit politik dhe ekonomik.

**Faktorët kritik të lidhur me suksesin e përvojës:** Suksesi i përvojës është i lidhur me statusin e neutralitetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Ekipet e OSBE-së janë të perceptuara si neutrale dhe të besueshme nga të gjitha komunitetet.

**Dëshmia e efikasitetit:** Interesim i madh dhe pjesëmarrje aktive e të rinjëve

**Përparsitë e ushtrimit:** Përvoja/praktika është një sukses , duke iu falenderuar bashkëpunimit të disa akterëve, duke filluar nga drejtorët e shkollave deri te autoritetet lokale, por mbi të gjitha duke iu falenderuar angazhimit të madh të nxënësve.

**Dobësitë e ushtrimit:** Përvoja është ende e mvarur nga përkrahja e OSBE-së dhe përpjekja për të mbajtur të përfshira të gjitha komunitetet.

**Kushtet e nevojshme për përshtatje në kontekstet tjera:** Zgjedh një ekip neutral të menagjimit të projekteve i cili është në gjendje të bindë të gjitha palët, duke përfshirë autoritetet lokale , drejtorët e shkollave dhe mësuesit.

**Informatat kontaktuese dhe informacionet tjera:**

Misioni i OSBE-së në Kosovë

Qendra regjionale Gjilan